

K Ë R K E S Ë

PËR SHPALLJE TË VDEKUR TË NAXHI IRFAN OHRIT

GJYKATËS SË RRETHIT TË KAVAJËS

Kërkuese: Dëshira Ohri, e bija e Irfanit dhe e Meleqes, datëlindja 1937, banuese në lagjen nr.3, Kavajë.

Objekti: Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së Naxhi Irfan Ohrit, në bazë të nenit 15e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Jam me banim në qytetin e Kavajës, motra e Naxhi Irfan Ohrit, i cili në vitin 1944 është larguar jashtë shtetit dhe për një periudhë katër-pesë vjeçare në mënyrë indirekte kemi mësuar që ishte gjallë dhe se jetonte në Amerikë. Pas vitit 1950 humbëm çdo kontakt me vëllain tim Naxhi Ohri, kjo edhe për shkak të sistemit që ishte në fuqi në atë kohë ku ndalohej komunikimi me të larguarit jashtë shtetit për motive politike.

Meqenëse vëllai im Naxhi Irfan Ohri është larguar nga vendi i banimi dhe vendqendrimi i tij në Kavajë dhe për të nuk kemi lajme që është gjallë, kërkojmë të shpallet zhdukja dhe vdekja e tij më 1989, kjo sipas informacioneve gojore që kemi mundur të marrim për vdekjen e tij.

KËRKUESE
Dëshira Ohri